Kronikë

# Tiranë/ Policia i gjeti armë pa leje dhe mbi 100 fishekë në shtëpi, arrestohet 43-vjeçari në Vaqarr

*Operacioni i koduar "Guns" u finalizua nga shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, në koordinim me Prokurorinë e Tiranës.*

*Foto e armëve të sekuestruara*

Redaksia
18 Qershor, 13:36 | **Përditesimi: 18 Qershor, 13:43**

Share Post

Një 43-vjeçar është arrestuar sot në flagrancë në fshatin Allgjatë të Vaqarrit, pasi në banesën e tij u gjetën armë dhe municion që mbaheshin pa leje.

Operacioni i koduar "Guns" u finalizua nga shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, në koordinim me Prokurorinë e Tiranës.

Gjatë kontrollit në banesën e 43 vjeçarit S. A., policia sekuestroi një kallashnikov (AK-47), dy krehra dhe 81 fishekë kallashnikovi, si dhe një armë gjahu me 24 fishekë. Të gjitha armët dhe municionet mbaheshin pa leje.

Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë së Tiranës për veprime të mëtejshme.

**Njoftimi i plotë i Policisë së Shtetit**

> *"Tiranë/Finalizohet nga Komisariati Nr. 6, operacioni i koduar "Guns", kundër armëmbajtjes pa leje. Mbante në banesë, në fshatin Allgjatë, 2 armë, 2 krehra armësh dhe qindra fishekë, arrestohet në flagrancë 43-vjeçari.*
>
> *Sekuestrohen 1 kallashnikov, 1 armë gjahu, krehrat dhe municioni. Si rezultat i një hetimi të kryer nga shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, në koordinim me Prokurorinë e Tiranës, me synim dokumentimin e veprimtarisë kriminale të një shtetasi të dyshuar për posedim të kundërligjshëm të disa armëve, u finalizua operacioni i koduar "Guns", gjatë të cilit u arrestua në flagrancë shtetasi S. A., 43 vjeç.*
>
> *Gjatë kontrollit në banesën e tij, në fshatin Allgjatë, Vaqarr, u gjetën 1 armë zjarri (kallashnikov, AK-47), 2 krehra dhe 81 fishekë kallashnikovi, si dhe 1 armë gjahu me 24 fishekë, që posedoheshin pa leje.*
>
> *Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme:"*

U.D/Shqiptarja.com

TAG: arme zjarri | kallashnikov | Tirane | vaqarr

Komento

## Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
19 Qershor, 13:51
**A kanë të drejtë SPAK dhe gjykatat të ndalojnë prezencën e kamerave gjatë seancave publike?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

**Protesta/ Ish-luftëtari i UÇK-së lexon listën me kërkesat: Rama dorëheqje, qeveri teknike! Harrojnë fare Berishën! Reagimi i Ramës: Protestës i ranë puplat nga zëdhënësi i Iranit!**
22 Qershor, 19:16



**Ndërhyrja në kohë shmang tragjedinë në Laprakë, familja me dy fëmijë evakuohet nga banesa e përfshirë nga zjarri**
22 Qershor, 18:25

**'Këngë dhe Rituale'- Një Suitë Jazz mbi Kujtesën Shqiptare**
22 Qershor, 18:17

**Ylli Manjani: Rama pas revolucionit 'flamingo'**
Ylli Manjani
22 Qershor, 10:35

**Spikerica e Iranit/ Ikballe Huduti në protestat e Tiranës, kërkon dorëheqjen e Edi Ramës**
22 Qershor, 09:16

**Ishte i bllokuar nga grupi i protestuesve që e gdhinë në bulevard, lirohet kalimi para kryeministrisë**
22 Qershor, 07:48

**Osman Stafa kallëzon dy persona në polici: Më fyen dhe sulmuan fizikisht! Qytetarët: Na kërkoi llogari pse s'ishim në protestë**
21 Qershor, 23:28

**Protesta para Kryeministrisë, moment tensioni mes organizatorëve! Reagime për përdhosjen e flamurit izraelit: Ka grupe të infiltruara, distancohemi!**
21 Qershor, 19:09

**Taulant Balla takohet me të rinjtë në Vorë: Shumica e shqiptarëve e mbështesin projektin në Vlorë!**
21 Qershor, 17:53

**Tiranë/ Gjimnazi 'Sulejman Elezi' në Laknas drejt përfundimit, në shtator pret 520 nxënës**
21 Qershor, 11:11

**Disa dhjetëra protestues për 24 orë bllokuan bulevardin para kryeministrisë dhe penguan lëvizjen e makinave, 9 prej tyre nën hetim**
21 Qershor, 08:26

**FOTOLAJM/ Pas protestës, kapelja me simbolin e shqiponjës përfundon në koshin e plehrave**
20 Qershor, 23:41

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje